VENDIM
Nr. 52, datë 14.12.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 15, DATË 3.4.2013 "PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME BERAT–KUÇOVË"

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 15, datë 3.4.2013, "Për rinovim licence sh.a Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë", bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

- Drejtues ligjor z. Refat Harizi;
- Drejtuesi teknik: z. Lulzim Sino.

KRYETARI
Ndriçim Shani